



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA VLORE
KËSHILLI I BASHKISË

Nr. 13383 Prot

Vlorë, më 11.08 2025

Lënda: Njoftim për mbledhjen jashtë radhe të Këshillit të Bashkisë, datë 18.08.2025.

ANËTARËVE TË KËSHILLIT TË BASHKISË VLORE

Për dijeni: KRYETARIT TË BASHKISË VLORE

PREFEKTIT TË QARKUT VLORE

Ju njoftoj se, **ditën e hënë, datë 18.08.2025, ora 10:00**, në Pallatin e Kulturës “Labëria” do të zhvillohet mbledhja jashtë radhe e Këshillit të Bashkisë Vlorë, e thirrur nga Kryesia e Këshillit, në bazë të Ligjit Nr. 139/2015, neni 53 pika 4, ku pas ;

1. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së këshillit të bashkisë, datë 21.07.2025.
2. Shprehje për ligjshmërinë e Vendimeve të Këshillit të Bashkisë Nr 62 - 67, datë 21.07.2025;

Do të vazhdojmë me këtë rend dite:

1. Projektvendim “Për dhënien e ndihmës ekonomike nga të ardhurat e bashkisë, për muajin Korrik 2025”.
2. Projektvendim “Për dhënien e ndihmës ekonomike nga fondi i kushtëzuar për muajin Korrik 2025”.
3. Projektvendim “Për miratimin e projekt marrëveshjes së bashkëpunimit “Për zbatimin e projektit të investimit “Për zhvillimin dhe menaxhimin e pronës shtetërore”, në projektin “Rijetësimi i kompleksit sportiv “Flamurtari” Vlorë, Stadiumit, Pallatit të Sportit dhe zonës urbane përreth, dhe dhënia e autorizimit kryetarit të bashkisë për nënshkrimin e marrëveshjes”.
4. Projektvendim “Për dhënie titulli “Qytetar Nderi i Vlorës” zotit Albert Mustafaj”.
5. Projektvendim “Për dhënie titulli “Qytetar Nderi i Vlorës” zotit Veni Bodo”.

Kryesia e Këshillit të Bashkisë, do të mbledhet në mjediset e Bashkisë Vlorë, ditën e hënë , datë 11.08.2025, ora 13:00.

Komisionet e përhershme, do të mbledhen në mjediset e Bashkisë Vlorë, si më poshtë :

Komisioni juridik, i rendit dhe i sigurisë vendore publike, do të mbledhet ditën e mërkurë , datë 13.08.2025 , ora 12:00.

Komisioni për çështjet e ekonomisë, financave dhe privatizimet, do të mbledhet ditën e mërkurë , datë 13.08.2025, ora 13:00.

Komisioni i shërbimeve publike, transportit, infrastrukturës dhe strehimit do të mbledhet ditën e mërkurë, datë 13.08.2025, ora 14:00.

Komisioni për zhvillimin urbanistik dhe ndërtimet, do të mbledhet ditën e enjte, datë 14.08.2025, ora 12:00.

Komisioni për arsimin, kulturën dhe sportet, do të mbledhet ditën e enjte, datë 14.08.2025, ora 13:00.

V.O. Bazuar në rendin e ditës të sipërcituar, nëse ndonjë nga Komisionet e Përhershme, vlerëson se, duhet të mbledhet për çështjet që trajtojnë projektvendimet, Kryetari i Komisionit të njoftojë anëtarët e komisionit përkatës, për datën dhe orën e mbledhjes.

KRYETAR
Elpiniq Merkur





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**BASHKIA VLORE
KËSHILLI I BASHKISË**

Nr. 13388 Prot.

Vlorë, më 11.08 . 2025

VENDIM

Nr 9, datë 11.08.2025

**MIRATIMI I NJOFTIMIT DHE RENDIT TË DITËS PËR MBLEDHJEN JASHTË
RADHE**

Në mbështetje të Ligjit nr.139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”, Neni 17,53, pika 3, 56, pika 2 dhe Rregulloren “Për Organizmin dhe Funksonimin e Këshillit të Bashkisë Vlorë” neni 60, Kryesia e Këshillit të Bashkisë Vlorë, në mbledhjen e datës 11.08.2025,

VENDOSI:

1. Miratimin e njoftimit dhe rendit të ditës për mbledhjen jashtë radhe të Këshillit të Bashkisë Vlorë, e cila do të mbahet në datën 18.08.2025.
2. Ngarkohet Sekretari i Këshillit dhe, në mungesë të tij, Kryetari i Këshillit për bërjen publike të njoftimit dhe rendit të ditës së mbledhjes dhe dërgimin e njoftimit dhe rendit të ditës te çdo këshilltar, te Kryetari i Bashkisë Vlorë, Deputetët e Bashkisë Vlorë dhe personat apo/dhe organizatat që kanë paraqitur kërkesë për të marrë njoftim të rregullt, si dhe përgatitjen e materialeve të mbledhjes dhe dërgimin e tyre te secili këshilltar dhe te Kryetari i Bashkisë Vlorë.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETAR

Elpiniqi Mërkuri

